

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-25-764-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Blerja e shërbimit për transportimin e komponentave të turbinës dhe gjeneratorit elektrik në TCB**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	Bionics SH.P.K.
NUI	811352385
Adresa	Rruga Ali Hadri, Bll.4,PD1 1-2
Vendi	Prishtinë
Kodi postar	10000
Numri Telefonit	045523065
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Rexhep Bunjaku
Adresa elektronike	bionicsshpk@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	17.05.2025

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtrojë ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Blerja e shërbimit për transportimin e komponentave të turbinës dhe gjeneratorit elektrik në TCB

- Me datën 12.02.2025 është bërë njoftimi për kontratë.
- Me datën 13.02.2025 është bërë hapja e ofertave, dhe publikimi i Hapjes së ofertave.
- Me datën 02.05.2025, AK ka publikuar vendimin për dhënien e kontratës, dhe Eliminimin e OE ankues.
- Me datën 05.05.2025, ne kemi bërë kërkesë për qasje në dokumente, ofertat , raportin e komisionit dhe Sqarimet shitesë nëse ka patur.
- Me datën 05.05.2025, na është mundur qasja në vetem disa dokumente

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

- Me datën 07.05.2025 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim në AK.
- Me datën 08.05.2025 kemi pranuar përgjigje në kërkesën për rishqyrtim nga AK quditrisht të pabazuar edhe përkunder fakteve të ofruara.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi

Neni 7 – Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi

Neni 10 – Mjetet për promovimin e performancës

Neni 28 – Specifikimet teknike

Neni 51 – Njoftimi i kriterëve të përzgjedhjes

Neni 56 – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve

Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pretendimi Nr. 1: Gjysëmrimorkio me numër të regjistrimit 05-717-XB dhe Kohëtërheqësja me numër të regjistrimit 05-142-FM janë ofruar në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe sqarimeve të dhëna nga AK

Në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar, AK ka theksuar se gjysëmrimorkio e ofruar nga ne si OE Ankues nuk plotëson kriterin e peshës bartesë, pasi që pesha maksimale e lejuar është 59820kg, kurse kriteri i përcaktuar ka qenë 65ton apo 65000kg.

Një konstatim i tillë nga AK është i pasakte dhe në kundërshtim me vet kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit dhe në sqarimet e ofruara për OE të interesuara. Sipas Kërkesës 9.1 dhe 9.2 Kapaciteti Teknik dhe profesional, të DT, parashihet se pesha e bartjes së automjetit transportues të jetë minimum 65ton. Në sqarimet e ofruara me datë 14 mars 2025, në pyetjen se nëse pesha 65 ton i referohet vetëm kamionit apo tërësisë kamion dhe rimorkio, AK është përgjigjur se "kamioni

dhe rimorkio duhet të bartin-transportojnë peshën 65t dmth si tërësi" (shih Dokumentin Sqarimet_14.03.2025.pdf)

Pra, vet AK ka dhënë këtë përgjigje, e cila e konfirmon pretendimin ankimor tonë si OE Ankues, dhe konfirmon se këtë kriter të DT e kemi plotësuar në tërësi pasi që Gjysëmrिमorkio me numër të regjistrimit 05-717-XB dhe Kohëtërheqësja me numër të regjistrimit 05-142-FM, së bashku kanë 80.41t.

Sipas Nenit 56, paragrafi 3 të LPP-së parashihet qartë se: "tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e tenderimit në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Për këtë pretendim në kërkesën tonë për rishqyrim AK, përgjigjet me injorim duke cituar vetëm përgjigjen e pyetjes 2 të sqarimeve të datës 14.03.2025. duke e keq interpretuar termin "si tërësi" dhe nuk e lexon fare pyetjen e kësaj përgjigjeje e cila është e qarte dhe explicite ku thotë " Ju lutem të sqaroni nëse i referoheni vetëm kamionit apo tërësisë kamion dhe rimorkio ?" dhe përgjigja në këtë pyetje është "Kamioni dhe rimorkio duhet të bartin-transportojnë peshën 65t d.m.th. si tërësi". Pra nga shihet qart se termi "tërësi" në këtë rast nënkupton tërësin kamion dhe rimorkio e nuk ka të bëjë me ngarkesën sic e ka interpretuar komisioni i vlerësimit dhe AK në përgjigjen e Kërkesës për Rishqyrtim.

Për më tepër AK në arsyetimin e tij në rastin kur e refuzon kërkesën tonë të rishqyrtimit thotë:

"Pesha e cila vendoset ne gjysëm rimorkio shpërndahet në akset e Gjysëm rimorkios dhe një pjese përmes nyjës lidhëse në mes Kokës terheqëse dhe Gjysmërimorkios (apo si quhet nga Institucionet përkatëse shtetërore "mbështetja në shalë") shpërndahet ne Kokën tërheqëse, pra shuma e te gjitha forcave bartëse të Gjysmërimorkios (te akseve dhe nyjës lidhëse) duhet te jete me e madhe se 65 ton."

Në dosjen e tenderit është kërkuar që të dorëzohen dokumentet e kamionit dhe rimorkios dhe jo llogaritjet e shpërndarjes së peshave në akse, nëse AK dhe komisioni i pranimit ka pasur përgaditjen e duhur për të bërë një interpretim të tillë të shpërndarjes së peshave në akse për "mbështetjen në shalë" atëherë është dashur të dijë të bëjë edhe llogaritjet për Kamionin dhe Rimorkion me të cilat ne kemi ofertuar sepse dokumentacionin e prodhimit së bashku me librezat e qarkullimit të Republikës së Kosovës i kemi dorëzuar në dosje me rastin e ofertimit. E në rast se

ka pasur dyshime, AK ka mundur edhe të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 53 të LPP. Mirëpo një gjë e tillë as nuk është kërkuar nga dosja e tenderit e as nuk është llogaritur nga komisioni i vlerësimit, **vetëm është përdorur kinse për të arsyetuar refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.** Një qasje e tillë e komisionit të vlerësimit është e pa pranueshme për ne si Grup Ekonomik me kompani lidere në fushën e transportit të peshave të rënda në Kosovë dhe më gjerë sepse nuk është etike të bësh ekspertin për një interpretim dhe të njejtin të mos e aplikosh tek të gjitha ofertat e OE-ve edhe nëse një interpretim i tillë është bërë jashtë kërkesave të dosjes së tenderit. Sepse kjo të bënë favorizues ndaj nje OE duke i diskriminuar OE e tjerë, e sidomos neve ne kete rast duke qene ofertues me qmimin me te lire dhe oferte te pergjegjshme.

Faktin se asnjëherë nuk është kërkuar të bartet ngarkesa prej 65t vetëm nga rimorkio e dëshmon edhe **Aneksi 1 i Dosjes së Tenderit ku janë specifikuar të gjitha ngarkesat që duhet të barten veç e veç dhe asnjëra nga to nuk e kalon peshën totale prej 58t** (shih Ankesi 1 ne Dosjen e Tenderit). E njejta gjë është konfirmuar edhe nga vete inxhinieriët e AK me rastin e site-visit.

Per kete rast, rimorkio e dorezuar ne oferten tone teknike permban peshen maksimale te ngarkeses se lejuar eshte 59820 kg ose 59.82t me qka e tejkalon peshen e ngarkeses qe duhet bartur (shih Dokumentin *Libreza_Rimorkio_Broshuis.pdf*, pika F1).

Kjo dëshmon se specifikimet teknike në Aneksin 1, kërkesat tek Kapaciteti teknik dhe profesional, dhe Sqarimet në pyetjet e OE-ve të datës 14.03.2025 (pyetja 2) kanë qen në harmoni, mirëpo komisioni i vlerësimit vendos që ti injoroj dhe jep pretendime të tilla të pavërteta, vetëm për ta eliminuar ofertën tonë.

Rrjedhimisht, duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe faktet e prezantuara më lart, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që këtë pretendim tonin t'a aprovtojë si të bazuar.

Pretendimi Nr. 2: Sekret i Afarist i OE Fitues

Ne si OE Ankues theksojm se Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosovës – ka lejuar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores për Prokurimin Publik, që e gjithë oferta e OE Fitues të konsiderohet si sekret afarist.

Sipas Autoritetit Kontraktues, pjesa dërmuese e dosjes së GOE Fitues janë sekret afarist, pasi që dokumentet janë të markuara si sekret afarist dhe është plotësuar Aneksi 3 i Dosjes së Tenderit. Me këtë arsyetim, dhe citimin e disa dispozitave ligjore, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën tonë për qasje në dokumente dhe kërkesën tonë për rishqyrtim.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues në mënyrë të kundërligjshme na ka mohuar qasjen në

ofertën e Operatori Ekonomik CONEX L.L.C të rekomanduar për kontratë, edhe pse dokumentacioni në fjalë nuk mund të konsiderohet si sekret afarist, pasi që dokumentacioni i mbrojtur si sekret nuk përbën sekret afarist dhe sekreti afarist nuk është përmbushur në mënyrën e duhur.

Jo të gjitha dokumentet në një ofertë mund të cilësohen si sekret afarist. Sipas nenit 11 të Ligjit për Prokurimin Publik, ky nen thotë që AK duhet të përgatitë një version të pastruar, përmes të cilit AK duhet të bëjë ndarje se cilat të dhëna mund të konsiderohen si sekrete afariste dhe cilat jo. Në këtë rast, AK ka konsideruar të gjitha dokumentat që OE fitues ka kërkuar të jenë sekret afarist pa vlerësuar fare se cilat mund të konsiderohen si sekret afarist e cilat jo. Nuk mund të konsiderohet si sekret afarist dokumentacioni (leja e qarkullimit të gjysëmrimorkios, kokëterheqësës apo automjeteve tjera transportuese), pasi që ato janë publike dhe targat e tyre janë të vendosura në to, që nënkupton se janë të njohura për publikun.

Neni 7.5 i RRPP përcakton se informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:

- a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se;
- b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP[1]se.

Pra, vetëm pasqyrat financiare si dhe informacionet që ndërlidhen me produktet sipas nenit 69 i LPP-se mund të klasifikohen si informacione sekrete.

Neni 69 i LPP i referohet karakteristikës së produktit dhe jo mënyrës se si një operator e ofron shërbimin. Neni 69 i LPP nuk i referohet karakteristikave të shërbimit por produktit.

Neni 7.5 i RRPP lidhur me nenin 69 i LPP-se synon të mbroje informatat lidhur me sekretin e furnizimit të OE me produkte, por jo të mbaje sekret edhe mënyrën se i njëjti do të kryej punën sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Dosja e tenderit ka specifika teknike dhe administrative për operatorë, të cilët janë vendimtare për procedurën e përzgjedhjes së operatorit fitues.

Një operatorë nuk mund të mbaje sekret nëse i përmbushë kriteret e përcaktuesë për të fituar kontratën. Kriteret përcaktuesë janë numër i punëtorëve, licencat, makineritë etj. Një OE nuk mund të mbajë të fshehur këto informata përcaktuesë ndaj konkurrencës. Këto informata nuk kanë të bëjnë me sekretin e produktit sipas nenit 69 i LPPse, por kanë të bëjnë me aftësinë e OE për të ofruar një shërbim sipas kriterëve përcaktuesë në Dosjen e Tenderit. Prandaj, nëse OE ankues kemi të drejtë në qasje të dokumenteve të tenderit të OE fitues CONEX L.L.C sa i përket kriterëve të përcaktuara me dosje të tenderit.

Licencat nga autoritet publike te Kosovës për kryejnë e punimeve nuk mund të konsiderohen si sekret afarist. Këto janë kritere kualifikuese në raport me operatorët e tjerë konkurrent ne procedure. Prandaj, AK ka vepruar në kundërshtim me LPP pasi që vetëm informatat që mbulohen nga neni 7.5 i RRPP mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste dhe jo edhe dokumentet e tjera.

Ne rastin konkret AK i ka klasifikuar te gjitha dokumentet e OE CONEX L.L.C si sekret afarist, duke përfshirë të gjitha dokumentat që kanë qenë kritere kualifikuese perfshire librezat e regjistrimit te automjeteve të lëshuara nga autoritet publike (qe ne fakt janë dokumente publike) si dhe te gjitha informatat tjera të cilat ishin krye për përzgjedhjen e ofertës fituese.

Përmes kualifikimit te gjitha dokumenteve të OE CONEX L.L.C. si sekrete AK na ka pamundësuar neve si OE qasjen ne dokumentet kualifikuese dhe përcaktuese për dhënien e tenderit këtij Operatori Ekonomik. Duke qenë kështu, AK ka shkelur mbi parimin e transparencës dhe të drejtës së OE ankues në qasje në dokumente sipas 10.3 të LPP. Konform nenit 10.2 te LPP, AK ka për detyre që OE ti jap qasje në të gjitha dokumentet e pranuar. AK nuk mund t'i kualifikoj të gjitha dokumentet e një operatori si sekret afarist, posaçërisht nëse këto informata përcaktohen në dosje të tenderit si krye për kualifikim dhe dhënie të tenderit. OE konkurrent duhen të kenë mundësinë që të verifikojnë nëse një OE konkurrent i përbush kryeret e kualifikimit dhe kryeret përcaktuese për fitimin e kontratës.

Poashtu neni 7 i RRPP-së, pika 7.3 po ashtu thotë se: Pas publikimit të rezultatit mbi vendimin e AK vetëm informatat e klasifikuara nga OE dhe **të pranuar** nga AK si sekrete të biznesit do të mbeshin sekrete për të gjitha palët duke përjashtuar KRPP, OSHP, përfshirë ekspertin shqyrtues dhe panelin shqyrtues dhe gjykatat kompetente.

Pra, sipas Legjislacionit në fuqi, dokumentet të cilat deklarohen si sekrete afariste nga ana e Operatorëve Ekonomik, të njëjtat cilësohen të tilla vetëm pasi të jenë të **pranuar** si sekrete afariste edhe nga ana e Autoritetit Kontraktues. Nga kjo çfarë u sqarua më lartë, vlerësojmë që AK duhet të krijoj një version të pastruar të dokumenteve, sekret afarist duhet të mbeshin të gjitha ato dokumente apo të dhëna për të cilat edhe vet AK është bindur se me të vërtetë, shpërndarja e tyre tek operatorët e tjerë, mund të shkaktojnë çfarëdo dëmi për OE i rekomanduar. **Version i pastruar nënkupton që nga dokumenti i konsideruar si sekret afarist duhet të cenzurohen vetëm ato pjesë që janë sekret afarist dhe jo tërë dokumenti. Në këtë rast, OE Fitues dhe AK duhet të dëshmojnë se cili është dëmi që mund t'i shkaktohet OE Fitues, nëse leja e qarkullimit/libreza i lejohet OE të tjerë në qasje apo shikim.**

Andaj duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura më lart, kërkojm nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që këtë pretendim të shpall të bazuar.

Bazuar ne argumentet e ofruara me sipër i propozojmë Panelit shqyrtues të OSHP-së, si organ profesional që është, që ankesën tone t'a **APROVOJË** si të bazuar dhe këtë aktivitet të prokurimit t'a kthejë në rivlerësim, duke e detyruar autoritetin kontraktues që t'a **ANULOJË**: “Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues” të dt. 02.05.2025, dhe “Letër standarde për tenderuesin e eliminuar” të dt. 02.05.2022 të këtij aktiviteti të prokurimit si dhe ofertën tonë ta legjitimojë si ofertë të përgjegjeshme.

Në rast se paneli shqyrtues mbanë seancë dëgjimore i propozojmë që nëse e shef të arsyeshme të na ftojë edhe neve për pjesëmarrje në seancë me qëllim të ofrimit dhe sqarimit të fakteve dhe provave tona edhe ne seancë dëgjimore.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Fitimi i planifikuar për realizimin e projektit
- Shpenzimet e perfaqesimit juridik/gjyqësor

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.